

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kalohen me 99.9% të fondit"/ Debate te Komisioni për Nismat Qytetare për tenderët
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/kalohen-me-999-te-fondit-debate-te-komisioni-per-nismat-qytetare-per--i474211
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:03:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f0c8067a1289d7dbcb8da609a5588baa463ca8745a3267e58b94c3134e21e1bc
TEKSTI	ed87f6e0de5362151f1a4cb1a9b17cad06cc5d4c5dea8d302fe99d40985f7c7a
PAMJA	7bf4d68b9301a1d7f06d47ea8bda1bb2413f4f3fdb3dbd691a9b33de474363f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	071dc532ad869427785aa92560afd027c03e31ef47c95fa0db9409874caa1e92
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/071dc532ad869427785aa92560afd027c03e31ef47c95fa0db9409874caa1e92>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

“Kalohen me 99.9% të fondit”/ Debate te Komisioni për Nismat Qytetare për tenderët



15 Shtator 2026, 12:48, Aktualitet CNA



Në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale janë zhvilluar debate në lidhje procedurat e tenderëve.

Anëtarët e opozitës në Komision, Gjini Gjoni dhe Ivi Kaso, i kanë drejtuar pyetje drejtoreshës së Agjencisë së Prokurimit Publik, Reida Kashta, për “flamujt e kuq” në procedurat e tenderimit, problematikat e konkurrencës dhe çështjen e KAYO-s.

Kaso, nga ana tjetër, është shprehur se ka raste të caktuara tenderuese ku procedura përfundon me vetëm një ofertues dhe me 99.99% të fondit limit, ndërsa ka ngritur pyetjen se sa para kursehen nga hapja e këtyre tenderëve.

Replikat:

Gjoni: Në sistem ka disa procedura tenderuese me flamur të kuq. Gjithashtu, a janë shqetësim për juve kontratat e partneritetit publik-privat dhe çështja e KAYO-s, ku shteti ka vetëm 20% në totalin e bashkimit me kompanitë private?

Kashta: Që sistemi PPP të funksionojë, duhet të ketë legjislacion të mirë. Kjo po bëhet dhe nuk është nevoja për rregullime ekstra. Duhet të ketë institucione të qarta me kompetenca të qarta, kapacitete njerëzore që dinë se si ta zbatojnë legjislacionin dhe për këtë po punojmë me trajnime. Duhet një sistem elektronik, të cilin ne e kemi. Nëse ne hapim sistemin, shohim çdo procedurë prokurimi, nuk ka shanse të mos jetë aty. Çdo gjë është publike. Kam akses të plotë në informacion, kemi krijuar bazën e parë që sistemi të jetë i drejtë dhe konkurrues. Nëse ka pretendime për një kriter, kemi një sistem efektiv ankesash. Sa i përket çështjes së KAYO-s, rregullohet me një ligj që ne si institucion nuk kemi kompetenca.


Gjoni: Nuk mora përgjigje për KAYO-n, as për flamujt e kuq dhe as për PPP-të, por më duhet të largohem për shkak të angazhimit në Komisionin e Ligjeve.

Kaso: Ka lajme të bëra publike për procedura e tenderë të mëdhenj që janë qartazi të ndarë sipas vullnetit politik. Ju duhet të bëni akrobaci në BE për deklaratat e kryeministrit që thotë se duhet ta bindja një kompani, ndërkohë që duhet të ishte garë. Ndërkohë, ish-ministria akuzohet për takime në tavoline për tenderë të mëdhenj dhe nuk turpërohet aspak. Këtë problem nga vendet që po anëtarësohen në BE, vetëm ju e keni të vështirë. Në lidhje me këtë e kuptoj vështirësinë e institucionit tuaj. Gjithashtu në tenderë të caktuar ka vetëm

një ofertues, të tjerët kanë mungesë dokumentacioni që të skualifikohen. Në gara të caktuara tenderuese ka raste kur kompanitë bëjnë gabime trashanike dhe përfundohet me vetëm një ofertues dhe me 99.99% të fondit limit. Sa para kursehen nga hapjet e këtyre tenderëve? Cilat janë sfidat tuaja sa i përket legjislacionit?

Kashta: E drejtë për të gjithë treguesit që përmendët. E masim fitimin dhe bëjmë krahasime vit për vit, kriteret po ashtu. Ne i studiojmë për të parë se ku mund të ndërhyjmë për të përmirësuar procesin. Në rastin e kriterëve, ne japim rekomandime. Në momentin kur shpallet, japim kriteret në raste individuale. Këto masa që ne kemi marrë janë të matshme dhe kanë tregues që vijnë në rritje. Puna vazhdon dhe procesi është transparent, ky është çelësi. Çdokush ka mundësinë të ndërveprojë me procesin. Sa u përket ofertave që vihen në funksion të një tjetre, nuk ka nevojë të kesh shumë oferta për të mbyllur procesin me sukses. Mjafton edhe një kompani e vetme. Gjithçka është transparente. Nuk ka kuptim të futet një kompani në shërbim të një tjetre, sepse nëse ka dokumentacionin, edhe një kompani e fiton tenderin. Kuvendi mund të ketë një rol në shpejtësinë e procesit të ankesave, për nxitje në shpejtësinë e gjithë procesit në vetvete.

Kaso: I vini rëndësi transparencës, por nuk është kjo e vetmja gjë që duhet. Ka shumë herë procedura nën dritën e diellit, por pa aftësi për t'i parandaluar apo luftuar me procedura administrative. /CNA



Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Kërkoi lirim nga qelia/ GJKKO jep vendimin për Metën

Veliaj ngelet në burg/ Protestuesit brohorasin për vendimin ndaj kryebashkiakut

Goditja e radhës për Erion Veliajn/ Gjykata e Lartë e lë në burg

Rritja e çmimit të naftës/ Bozdo: Situata emergjente, qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Audio-përgjimi për Ron Yeffet/ Kalaja: Rama ka dalë zbuluar me korrupsionin e tij

Seanca për Veliajn/ Protestë para Gjykatës së Lartë

Emërohet Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së

Dosja “Revanshi”/ GJKKO shpall vendimin për Durim Bamin dhe 6 të tjerë

"O gjyqtar bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli"/ Thirrja e protestuesve para Gjykatës së Lartë

Erion Veliaj kërkon të kthehet në vendin e krimit/ Sot, seanca në Gjykatën e Lartë

Projekti për bujqësinë/ BB: Mund të ristrukturohet ose të anulohen fonde

Protesta para shkollës/ Hoxha: Goditja ndaj protestuesit ishte për ta përkulur

“Rama dhunoi pasagjerin”/ Berisha: Kreu i organizatës çan me thonj qytetarin

“Nëse e keni harruar, kujtohuni nesër”/ Gjokutaj, mesazh gjykatave për afatet e paraburgimit

Audio-përgjimi/ Këllici: Roni i Ramës paska të gjithë qeverinë në dorë

Gazetari: 30 milionë euro të taksapaguesve janë dhënë për makina që saldojnë në një kapanon

"Mbështetuni te unë për Ministrinë e Energjetikës"/ Zbardhet një tjetër pjesë e audio-përgjimit për Ron Yeffet

Protestuesit para komisaritit numër 3: Lironi trimat, arrestoni Ramën

"Korrupsioni e dobëson shtetin"/ Mesazhet e protestuesve përmes pankartave


Gazetari: SPAK t'i hapë një çështje Sadushit, këtë ku ta kapësh të ngel në dorë

[editorial](#)

11:57 Editorial

Kur propaganda dhe mashtrimi dështojnë përballë drejtësisë

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Shënim: Dokumenti/ Acromax i Aldor Nini është nën kontroll CNA dhe akuzues nga DTKU

[opinion](#)

20:44 Opinione Albert Vataj

Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.